ask
AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria e Kosovës -Vlada Kosova - Government of Kosova*
Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera
Office of the Prime Minister

# RAPORTI VJETOR 2017



Prishtinë, 2018

# RAPORTI VJETOR 2017

Prishtinë, 2018

# PËRMBAJTJA

**Faqe**

PËRMBAJTJA........................................3
LISTA E SHKURTESAVE........................................4
HYRJE........................................6
*1.* PERFORMANCA E ASK-së........................................7
*1.1. Korniza Ligjore dhe dokumentet bazë* ........................................7
1.2. *Aktivitetet e Këshillit Statistikor* ........................................8
*1.3. Bashkëpunimi dhe Komunikimi* ........................................8
*1.4. Statistikat Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare* ........................................11
*1.5. Statistikat Sociale* ........................................12
*1.6. Statistikat e Bujqësisë dhe të Mjedisit* ........................................12
*1.7. Përpunimet e Veçanta të Statistikave Zyrtare* ........................................13
*1.8. Metodologjia, Shpërndarja dhe Teknologjia Informative* ........................................14
*1.9. Racionalizimi dhe Ngritja e Kapaciteteve në ASK* ........................................16
*1.10. Pasqyrat e Performancës së ASK-së* ........................................16
2. ANALIZA E PRIORITETEVE........................................28
3. BUXHETI........................................30
4. SFIDAT........................................32
*SHTOJCA 1. Të dhënat për të punësuarit në Shërbimin Civil të Kosovës në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, dhjetor 2017.* ........................................33
*SHTOJCA 2. Kalendari i publikimeve* ........................................34

# LISTA E SHKURTESAVE

| | | |
|---|---|---|
| **ABEF** | - | Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare |
| **AFP** | - | Anketa e Fuqisë Punëtore |
| **BPV** | - | Bruto Produkti Vendor |
| **DMTI** | - | Departamenti i Metodologjisë dhe i Teknologjisë Informative |
| **DSELLK** | - | Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare |
| **DSS** | - | Departamenti i Statistikave Sociale |
| **FMN** | - | Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| **IÇIMP** | - | Indeksi i Çmimeve të Importit |
| **IÇK** | - | Indeksi i Çmimeve të Konsumit |
| **IÇP** | - | Indeksi i Çmimeve të Prodhimit |
| **IKN** | - | Indeksi i Kostos së Ndërtimit |
| **KB** | - | Kombet e Bashkuara |
| **KKIQ** | - | Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit |
| **KNS** | - | Klasifikimi Ndërkombëtare i Sëmundjeve |
| **MD** | - | Ministria e Diasporës |
| **MPJ** | - | Ministria e Punëve të Jashtme |
| **MTI** | - | Ministria për Tregti dhe Industri |
| **NK** | - | Nomenklatura e Kombinuar |
| **NACE** (ang.) | - | Nomenklatura për Klasifikimin e Aktiviteteve Ekonomike |
| **PFB** | - | Pariteti i Fuqisë Blerëse |
| **QR** | - | Qarku Regjistrues |
| **R1, R2, R3**, | - | Formularët Individualë nga Regjistrimi i Popullsisë |
| **STJ** | - | Statistikat e Tregtisë së Jashtme |
| **SH** | - | Sistemi i Harmonizuar |
| **SIPK** (ang.) | - | Sistemi i Përdorimit të Kohës |
| **KVP** | - | Korniza e Vlerësimit të Performancës |
| **DRA** | - | Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit |
| **MICS** (ang.) | - | Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë |
| **ISBN** (ang.) | - | Numri Standard Ndërkombëtar i Librit |
| **GIS** (ang.) | - | Sistemi Informativ Gjeorgrafik |
| **PSZ** | - | Programi i Statistikave Zyrtare |
| **MeM** | - | Marrëveshje e Mirëkuptimit |
| **TM** | - | Tremujore |
| **IHÇK** | - | Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit |

| | | |
|---|---|---|
| **PRODCOM (ang)** | **-** | Klasifikimi i Produkteve |
| **ESA 2010 (ang)** | **-** | Sistemi Evropian i Llogarive |
| **MGSC (ang)** | - | Grupi i Menaxhmentit për Bashkëpunim Statistikor |
| **ESSPROS** (ang) | - | Sistemi Evropian i Statistikave të Integruara të Mbrojtjes Sociale |
| **LAMAS** (ang) | - | Grupi Punues i Eurostatit për Statistikat e Tregut të Punës |
| **SDMX** (ang) | - | Shkëmbimi i të Dhënave Statistikore dhe Metadatat |
| **ITDG** (ang) | - | Grupi i Drejtorëve për Teknologji Informative |
| **CPSA** (ang) | - | Komiteti Drejtues për Statistikat Bujqësore |
| **DIMESA** (ang) | - | Takimi e Drejtorëve për Statistikat e Mjedisit dhe Llogarive |
| **SBS** (ang) | - | Statistikat Strukturore të Biznesit |
| **ITGS** (ang) | - | Statistikat në Mallrat e Tregtisë Ndërkombëtare |
| **ETS** (ang) | - | Grupi i Punës për Statistikat e Arsimit dhe Trajnimit |
| **ESS** (ang) | - | Sisitemi Evropian Statistikor |
| **DGINS** (ang) | - | Takimi i Drejtorëve të Përgjithshëm të Instituteve Kombëtare të Statistikave |
| **DMES** (ang) | - | Takimi i Drejtorëve të Statistikave Makroekonomike |
| **EFGS** (ang) | - | Forumi Evropian për Statistikat Gjeografike |
| **PGSC** (ang) | - | Grupi i Politikave për Bashkëpunim Statistikor |
| **BoP** (ang) | - | Bilanci i Pagesave |
| **CGST** (ang) | - | Grupi për Koordinimin e Statistikave të Transportit |
| **ICT** (ang) | - | Teknologjia për Informim dhe Komunikim |
| **ESMS (ang)** | - | Struktura e metadatave Euro-SDMX |
| **ESQRS (ang)** | - | Standardi ESS për Strukturën e Raporteve të Cilësisë |
| PP | - | Pilot Projekt |

# HYRJE

Raporti vjetor i Punës (2017), përgatitet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), në përputhje me Ligjin për Statistikat Zyrtare, përmes të cilit prezentohen të gjitha aktivitetet kryesore të realizuara sipas planit të punës të vitit përkatës. Informatat e prezentuara në raportin vjetor të punës, kanë për qëllim parësor ta mbajnë të informuar përdoruesin, institucionet e vendit dhe ato ndërkombëtare, për të arriturat dhe sfidat e Sistemit Statistikor të Kosovës, gjatë vitit 2017.

Gajtë periudhës pesë vjeçare, janë bërë ndryshime pozitive në fushën e statistikave zyrtare, gjegjësisht në Sistemin Statistikor të Kosovës. Nga përmbajtja e raportit këto ndryshime pozitive janë të dukshme, lehtësisht të krahasueshme me vitet paraprake. Viti 2017 karakterizohet me ndryshime pozitive si në aspektin e prodhimeve statistikore, të cilat bazohen në Programin e Statistikave Zyrtare 2013-2017, po ashtu edhe në aspektin e prezencës në nivel ndërkombëtar të ASK-së, siq është rasti i avancimit drejtë përfshierjes së plotë të Sistemit Statistikor të Kosovës në Sistemin Evropian të Statistikave.
Viti 2017, ishte vazhdimësi e rritjes së performancës së ASK-së. Përveç prodhimit të Statistikave zyrtare sipas kalendarit të publikimeve, janë zhvilluar edhe aktivitete tjera të rëndësishme, të cilat kanë zgjeruar gamen e prodhimeve statistikore për nevojat e përdoruesve ( raporti i pagave mesatare në sektorin publik dhe privat, etj). Gjithashtu, janë zhvilluar edhe procese tjera të cilat për funksion kanë zhvillimin e ASK-së në aspektin afatgjatë, siç është rasti i planifikimit nga ana e ASK-së i Pragamit të Statistikave Zyrtyare 2018-2022, i cili është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Mësimet e nxjerrura nga e kaluara, kanë ndihmuar ASK-në në hartimin e Planit Vjetor të punës, bazuar në resurset dhe mundësitë ekzistuese. Bazuar në këto planifikime, ASK-ja, ka realizyar planin e punës për vitin 2017, në përputhje të plotë me parashikimet. Kalendari i publikimeve është respektuar plotësisht dhe të gjitha raportet statistikore të publikuara, janë postuar në web faqen zyrtare të ASK-së, dhe janë komunikuar rezultatet tek mediat e ndryshme. Monitorimi i planit të punës 2017 si dhe të çdo viti tjetër, është bërë dhe vazhdon të bëhet përmes sistemit të SIPK-ut, ku pëfshihen elemente të rëndësishme të kodit të praktikës së statistikave evroinane sic janë kualiteti, koha prodhuese, prodhimi në kohë, etj. efikasiteti dhe efetkiviteti i ASK-së, gjatë vitit 2017, që janë dy elemente përcaktuese në përmirësmin e cilësisë së prodhimit të statistikave zyrtare, janë pjesë rendësishme e këtij Raporti Vjetor. Kjo matje është realizuar përmes Sistemit të SIPK-ut, i cili në vazhdimësi ia mundëson ASK-së vetëvlerësimin analitik, me qëllim të përmirësimit të performancës së saj gjatë një viti, dhe nga viti në vit. Performanca është e bazuar në pasqyrën e përpunuar me të dhënat e Sistemit të SIPK-ut.

Vlerësimi ndërkombëtar në vitin 2017, nga ekipi i ekspertëve të angazhuar nga Eurostati, i quajtur Vlerësimi "Peer Review", është e arritur shumë e madhe për Sistemin Statistikor të Kosovës në përgjithësi, dhe për ASK-në në veçanti. Vlerësimi në përgjithësi ishte shumë pozitiv për SSK dhe ASK-në, ku janë dhënë edhe 14 rekomandime te rendësishme bazuar në Kodin e Praktikës Evropiane për Statistika.

ASK-ja përveç të arriturave vazhdon të ketë edhe sfidat e saj, siç janë mungesa e resurseve njerëzore dhe infrastrukturore, mungesa e hapsirave të nevosjhme dhe kushteve të tjera për punë normale, që ndikon negativisht në punën e stafit të ASK-së, edhe përkundër sukseseve dhe progresit të arritur deri më tani nga ASK-ja.

Ky raport përveç informatave mbi zhvillimet dhe të arriturat e përgjithshme, matjes dhe fuqizimit të kornizës vlerësuese dhe monitoruese, gjithashtu, ofron informata për numrin e publikimeve, titujt e publikimeve dhe frekuencat e publikimeve në nivel të ASK–së, dhe fushave sektoriale që janë realizuar gjatë vitit 2017, krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa publikimet dhe të gjitha raportet tjera janë të postuara në web faqen zyrtare të saj: http://ask.rks-gov.net/

# *1.* PERFORMANCA E ASK-së

Para se të përshkruhen detajet e përformimit të ASK-së, për vitin 2017, më poshtë janë renditur vetëm disa zhvillime kryesore, siç janë:

- Realizimi “PEER REVIEW” 24-28 Korrik 2017, që është një ndër aktivitetet më të rëndësishme, në aspektin e ndërkombëtar të vlerësimit të Sistemit Statistikor të Kosovës, lidhur me përafrueshmërine me parimet e CoP;
- Hartimi i Programit të dytë tëStatistikave Zyrtare 2018-2022;
- Rishikimi i PKZMSA 2018-2021, në fushen e statistikave;
- Riprocesimi i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Statistika Zyrtare, edhe pas aprovimit dhe leximit të parë nga Kuvendi i Kosovës në fillim të vitit 2017;
- Ridizajnimi i web faqes së re të ASK-së
- Popullimi (rritja) me të dhëna statistikore i aplikacionit ASKDATA;
- Përfundimi i projektit 2014-2017, mbështetje nga SIDA Suedeze për Sistemin Statistikor të Kosovës;
- Përgatitja dhe bashkërendimi i aktiviteteve në mes të ASK-së - SIDAs dhe zyrës së BE-së, lidhur me projektin e ardhshëm 2018-2021, për përkrahje Sistemit Statistikor të Kosovës;
- Lansimi apo publikimi për herë të parë i disa titujve statistikor

## *1.1. Korniza Ligjore dhe dokumentet bazë*

Prodhimi i statistikave zyrtare të Republikës së Kosovës, rregullohet me ligjin mbi Statistikat Zyrtare nr. 04/L-036, përmes të cilit definohen detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Sistemit Statistikor të Kosovës në prodhimin e statistikave zyrtare . Agjencia e Statistikave të Kosovës, si dhe i tërë Sistemi shtetëror i Republikës së Kosovës, është i orientuar në proceset euro integruese, si orientim i përgjithshëm, si në aspektin afatshkurtër po ashtu dhe afatgjatë. Synimi i tillë në proceset integruese mbështetet edhe me procese tjera të cilat rregullojnë fushën e bashkëpunimit, dhe përafrimit të Sistemit Statistikor të Kosovës, me atë të BE-së.

Korniza ligjore si njër ndër parakushtet kryesore të zhvillimit është e domosdoshme të përshtatet dhe të zbatohet, në varësi me rrethanat dhe dinamiken e zhvillimeve tjera qoftë brenda vendit qoftë në arenën ndërkombëtare. Rritja e përformancës dhe e kontrollit të proceseve të ndryshme llogaridhënëse, si dhe përafrimi i kornizës ligjore të Kosovës me atë ndërkombëtare apo *ACQUIS*, janë zotime të rëndësishme, të cilat janë të përfshira në ndryshimet ligjore.

Si rrjedhoj, e këksaj të fundit, ASK-ja, ka bërë ndryshimet e nevojshme në Ligjin aktual të Statistikave Zyrtare në përputhje me rekomandimet e Eurostat-it të cilat janë të bazuara në frymën e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane (CoP) dhe Rregullores (KE) nr. 223/2009 mbi Statistikat Evropiane, të miratuar me 11 Mars 2009 nga Parlamenti Evropian. Qëllimi i ndryshimeve dhe plotësimeve ligjore është përafrimi me këtë Rregullore, funksionalizimi i Sistemit Statistikor të Kosovës, si dhe qendrueshmëria institucionale dhe profesionale të ASK-së. Ka pas stërgjatje të këtij procesi, pasi që ndryshimet dhe plotësimet ligjore janë procesuar e riprocesuar në Qeveri dhe Kuvendin e Kosovës që nga viti 2015.

Udhëzimi Administrativ nr.08/2012- Sipas Ligjit aktual mbi Statistikat Zyrtare, (Ligji nr. 04/L-036), neni 33, ASK-ja, ka të drejtën e prodhimit të statistikave të veçanta zyrtare, sipas kërkesave të shfytëzuesve. Për

realizimin e këtyre statistikave, ASK-ja ka zbatuar UA nr. 08/2012. Në ndërkohë Zyra e Auditorit të Përgjithsëm (ZAP-i) ka rekomanduar ndryshimin e disa pikave të UA aktual. Duke respektuar rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, ASK-ja ka ndërmarrë të gjtha veprimet e nevojshme për të ndryshuar dhe plotësuar UA nr. 08/2012 sipas kërkesave të ZAP-it, dhe të njëjtin e ka dërguar në Qeveri për aprovim, në fund të vitit 2015. ASK-ja edhe gjatë vitit 2017 ishte në pritje të aprovimit të këtij UA. Ky UA është rivendosur në Agjenden e Qeverisë për legjislacionin sekondar për vitin 2018.

Bazuar në Ligjin për Statistika Zyrtare, ASK-ja ka hartuar Planin Vjetor të punës për vitin 2018, si instrument për zbatimin e Programit pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare. Është bërë freskimi i Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (pjesa e statistikave) 2019-2021, plotësimi i pyetësorit për vetëvlerësim ( Peer Review), Harta Rrugore 2018, Rapori Vjetor 2016, Raporti Vjetor i Punës së Qeverisë (pjesa e ASK-së), si dhe raporte të tjera të dërguara në Eurostat dhe organizata tjera, me të cilat ASK-ja ka bashkëpunim në fushën e statistikave zyrtare.

## 1.2. *Aktivitetet e Këshillit Statistikor*

Këshilli Statistikor, është organ këshilldhënës për Sistemin Statistikor të Kosovës. Këshilli Statistikor (KS) ka funksionuar sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare Nr. 04/L-036, vendimit të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Nr. 097/2012 dhe Rregullores së KS .

Këshilli Statistikor, gjatë vitit 2017, ka dhënë 13 rekomandime lidhur me Sistemin Statistikor të Kosovës. Ky Këshill ka pushuar së funksionuari me skadimin e mandatit të tij ligjor më 3 prill 2017. Gjatë kohës sa ishte funksional, ky Këshill ka marrë pjesë në procesin e hartimit të dokumenteve me rëndësi, siç është Pragrami i Statistikave Zyrtare, dhe ka ofruar rekomandime të rëndësishme në fusha të caktuara statistikore.

Gjatë vitit 2017, KS ka mbajtur vetëm një takim, ku janë diskutuar dhe aprovuar rakomandimet e dhëna. Meqenëse, Ligji mbi Statistikat zyrtare është në proces të plotësim ndryshimit përmes të cilit janë propozuar ndryshime sa i përket numrit të anëtarëve në KS. Megjithatë ka vazhduar bashkëpunimi dhe involvimi i disa prej anëtareve të saj si pjesë e bashkëpunimit ndërinstitucional. Me aprovimin e ri të Ligjit për Statistikat Zyrtare, numri i anëtarëve të KS do të jetë 15.

## *1.3. Bashkëpunimi dhe Komunikimi*

ASK-ja tashmë ka vendosur dhe fuqizuar bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare, siç është Eurostat-i, agjencitë e OKB-së në Kosovë UNDP, UNICEF, UNFPA, Bankën Botërore, FMN-në, OECD-në dhe organiztata të tjera ndërkombëtare. Po ashtu është rritur bashkëpunimi edhe me institucionet dhe organiztata vendore.

Gjatë vitit 2017, përveç përfaqësimit në nivel të lartë të ASK-së, në forume të ndryshme, lidhur me zhvillimet strategjike qofte në nivel të Eurostat qoftë në nivele të tjera, ASK- ja është përfaqësuar edhe në aktivitete të tjera, si grupe punuese, punëtori, seminare, pilot projekte, vizita studimore, etj. të cilat kanë pasur një ndikim të madh në zhvillimin profesional dhe institucional,

Në format e tilla të bashkëpunimit, ASK-ja kryesisht ishte në rolin e marrësit të njohurive dhe ndarjes së përvojave përmes prezantimeve të ndryshme në forume të përbashkëta në tema të caktuara.

Me karakter bilateral gjatë vitit 2017, janë zhvilluar takime të përbashkëta me organizata të ndryshme, si Kosovë-OECD. Gjithashtu një delegacion kryesuar nga drejtoresha e përgjitshme e Instituti i Statistikave të Shqipërisë INSTAT, ishte për vizitë zyrtare në Agjencinë Statistikave të Kosovës, me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit në mes të dy institucioneve përkatëse dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e statistikave. Me këtë rast ASK-ja, e ka ndihmuar INSTAT-in, duke ia dhënë në përdorim Sistemin SIPK.

Vlenë të theksohet, gjatë vitit 2017 si rezulltat i bashkëpunimit me institucione të ndryshme ndërkombëtare nën asistencën teknike të FMN-së, tri institucionet bartëse te statistikave Zyrtare të Kosovës (ASK, BQK dhe MF) janë ndihmuar në zbatimin e Sistemit të Përgjithshëm më të avancuar të FMN-së për Shpërndarjen e të Dhënave (e-GDDS) të Republikës së Kosovës. Si rrjedhoje në këtë proces, është përgatitur dhe publikuar në ueb faqen e FMN-së, një përmbledhje e të dhënave Kombëtare (National Summary Data Page.

ASK-ja, ka vazhduar bashkëpunimin ndërinstitucional në fushën e statistikave me ministritë dhe agjencitë e tjera qeveritare. Përmes Marrëveshjeve së Mirëkuptimit me institucionet e tjera, ASK-ja, ka siguruar qasje dhe lehtësim në burimet administrative të të dhënave. Kjo, ka mundësuar ngritjen e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare dhe krahasueshmërinë me statistikat e prodhuara në sisteme të tjera statistikore. Bashkëpunimi ka vazhduar edhe me palë të tjera të interesit, si: me institucionet joqeveritare dhe donatorë të ndryshëm, me të cilët për një kohë të gjatë kanë ndihmuar ASK-në, në aspektin e ngritjes së kapaciteve prodhuese dhe profesionale. Ky bashkëpunim ka sjellë rritjen e sasisë, të cilësisë dhe të frekuencës së statistikave zyrtare sipas standardeve ndërkombëtare.

Në fushën e komunikimit përmes ueb-faqes së re të ASK-së, ka pasur lehtësime të shumta në fushën e komunikimit me përdorues, duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme për të dhënat më të fundit statistikore. Komunikimi me media, kontaktet me përdorues, qofshin institucione publike, organizata ose individë, është zhvilluar me metoda të ndryshme, qoftë përmes adresës zyrtare me shkrim, intervistave përmes telefonit, xhirimeve me kamerë, apo edhe përmes mediave sociale. Të gjitha raportet rreth komunikimit dhe informimit të përdoruesve tregojnë se, përformanca e ASK-së, ndaj kësaj pjese të përdoruesve është rritur.

Gjatë vitit 2017, është bërë edhe monitorimi i mediave në baza ditore. Kështu, janë evidentuar: 173 shkrime që kishin të bënin me ASK-në, prej tyre 56 shkrime në gazeta dhe 117 në media online. Ndërkaq, nga kërkesat e regjistruara nga përdoruesit e statistikave zyrtare, gjatë vitit 2017, ASK-ja ka pranuar 450 pyetje, për të cilat janë dhënë 352 përgjigje. Kurse, prej 19 kërkesave për prononcime në media (paraqitje në TV) janë realizuar 13 prej tyre.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) përmes publikimit dhe ofrimit të të dhënave të besueshme, të sakta, në kohë dhe të krahasueshme në nivel rajonal dhe më gjerë, gjithnjë e më shumë po bëhet partner i rëndësishëm dhe i besueshëm, si brenda vendit ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

**Figura: 1.1: Prania e ASK-së në media dhe përgjigjet ndaj përdoruesve të statistikave zyrtare**




Numri i vizitorëve në ueb faqen e ASK-së, vazhdon të jetë i lartë dhe varion nga muaji në muaj. Kështu, sipas Google Analytics, nga muaji prill e deri të muaji nëntor numri i vizitorëve ka arritur pothuajse dyfishin e saj. Kurse, numri i vizitorëve përgjatë gjithë vitit 2017 ishte 118 026.

**Figura: 1.2: Numri i vizitorëve në ueb faqen e ASK-së, 2017**



## 1.4. Statistikat Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare

Zbatimi i metodologjisë ndërkmbëtare në mënyrë të plotë duke përfshirë metodologjinë e Sistemit Evropian, të llogarive ESA 2010, është njëra ndër synimet e ASK-së në fushëveprimin e saj operativ dhe strategjik. Është shënuar progres në zbatimin e metodologjisë ESA 2010 në bazë të së cilës është bërë edhe publikimi i statistikave në fushën e statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare.

Gjatë vitit 2017 në fushen e statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara, sipas planit dhe dinamikes se paraparë. Gjatë këtij viti ka vazhduar progresi në rritjen e numrit të produkteve dhe shkurtimin e afateve kohore të publikimeve. Per herë te pare janë publikuar llogarite qeveritare në baza tremujore. Janë publikuar rezultatet e studimit "Kapacitetet e Turizmit (Njësitë Akomoduese) në Kosovë, 2016". Për të gjitha produktet ka vazhduar shkurtimi i afateve kohore të publikimit.

Me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe rritjes së indikatorëve janë kryer aktivitete të ndryshme. Është bëre ndryshimi i pyetësorit të industrisë në baza tremujore për kalkulimin e prodhimit industrial. Janë mbledhur dhe përpunuar të dhënat mbi qarkullimin turistik (hyrjet dhe daljet) në pikat (kalimet) kufitare për vitin 2017 në baza mujore. Te njëjtat do të publikohen në vitin 2018.

Në sektorin e Llogarive Kombëtare, janë publikuar: në baza tremujore Bruto Produkti Vendor (BPV) me qasjen e shpenzimeve dhe të prodhimit, për tremujorët (TM4 2016 –TM3 2017). Llogaritë Qeveritare në baza tremujore (TM4 2016 –TM3 2017).

Në baza vjetore, BPV me qasjen e shpenzimeve dhe të prodhimit për vitin 2016 dhe Llogaritë Qeveritare për vitin referues 2016.

Në Sektorin e Çmimeve janë publikuar Indekset e çmimeve në baza mujore (Konsumit), në baza tremujore (Importit, Prodhimit dhe Kostos së Ndërtimit) dhe në baza vjetore (Konsumit).

Në baza të rregullta mujore gjatë vitit 2017, është publikuar, "Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit" (IHÇK) për periudhat dhjetor 2016 - nëntor 2017.

Ndërsa në baza vjetore IHÇK është publikuar si produkt i veçantë për vitin 2016.

Në baza tremujore për periudhën Tremujori 4/2016 – Tremujori 3/2017, janë publikuar: "Indeksi i Çmimeve të Prodhimit" (IÇP), "Indeksi i Çmimeve të Importit" (IÇIMP) dhe "Indeksi i Kostos së Ndërtimit" (IKN). Mbështetur nga IPA MB 2014 është vazhduar me Projektin e Paritetit të Fuqisë Blerëse (PFB), që është në kuadër të Programit të Krahasueshmerisë Evropiane (ang. ECP).

Në sektorin e statistikave të bizneseve dhe të Tregtisë së Jashtme, janë kryer publikimet sipas titujve të ndryshëm në baza mujore, tremujore dhe vjetore.

Në baza mujore janë publikuar Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ) për periudhën dhjetor 2016 - nëntor 2017;

Në baza tremujore janë publikuar: "Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike", "Statistikat e Transportit", "Statistikat e Hotelerisë", "Bilanci i Energjisë", "Statistikat e Industrisë" dhe "Statistikat e Tregtisë me Pakicë", për periudhën (Tremujori i 4/ 2016 – Tremujori i 3/ 2017).

Në baza vjetore janë publikuar: Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (2016), Rezultatet e Anketës së PRODCOM-it (2016), Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ) (2016) dhe Bilanci i Energjisë në Kosovë (2016). Mbështetur nga donatoret janë publikuar rezultatet e studimit "Kapacitetet e Turizmit (Njësitë Akomoduese) në Kosovë, 2016".

Me qëllim të ngritjes së cilësisë së statistikave ekonomike, llogarive kombëtare dhe statistikave tjera që shfrytëzojnë Regjistrin Statistikor të Bizneseve në përgjithësi është kryer “Anketa për Përditësimin e Regjistrit Statistikor të Bizneseve”. Për ngritjen e cilësisë së statistikave te energjisë është realizuar anketa testuese (pilot) për “Konsumi i Energjisë në sektorin e shërbimeve”.

Në tërësi vetëm, në fushën e statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, janë publikuar gjithsej, 76 raporte statistikore në përputhje me kalendarin e publikimeve.

## 1.5. Statistikat Sociale

Në fushën e Statistikave Sociale janë realizuar pothuajse të gjitha aktivitetet e planifikuara me planin e punës për vitin 2017.

Sipas “Kalendarit të Publikimeve, gjatë vitit 2017” janë realizuar 6 publikime të Anketës së Fuqisë Punëtore, prej tyre tri publikime për vitin 2016 (Rezultatet për TM3 dhe TM4 2016, Rezultatet vjetore të AFP-së 2016 si dhe tri raporte tremujore të AFP-së për vitin 2017). Po ashtu janë publikuar Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) 2016, Statistikat e Mirëqenies Sociale 2016, Statistikat e Arsimit 2016-2017, Statistikat e Jurisprudencës për persona të mitur 2016, Statistikat e Jurisprudencës për persona të rritur, Statistikat e Shëndetësisë 2016 dhe Statistikat e Kulturës 2016.

Nga statistikat e popullsisë janë publikuar: Vlerësimi i popullsisë për vitin 2016, Lindjet, Vdekjet, Kurorëzimet dhe Shkurorëzimet, për vitin 2016.

Përveç publikimeve të rregullta, në fushën e Statistikave sociale janë publikuar edhe disa publikime statistikore të cilat ishin si rezultat i kërkesave të shfrytëzuesve të ndryshëm. Bazuar në këto kërkesa, janë publikuar edhe tri publikime të cilat nuk kanë qenë të planifikuara në “Kalendarin e Publikimeve të ASK-së 2017”, “Parashikimi i Popullsisë 2017-2061”, “Emrat dhe Mbiemrat në Kosovë” si dhe “Niveli i Pagave në Kosovë 2012-2016”.

Gjatë vitit 2017 gjithashtu është shënuar progres në shkurtimin e afateve kohore të publikimeve, rritjen e numrit të produkteve, si dhe për herë të parë është zhvilluar Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit në ekonomitë familjare (TIK).

Po ashtu është arritur të shkurtohen afatet kohore të publikimit të AFP-së si në baza tremujore po ashtu edhe në baza vjetore. Shkurtimi i afateve kohore është shënuar edhe të Statistikat e Mirëqenies Sociale. Për herë të parë është bërë transmetimi i mikro të dhënave në Eurostat për AFP-në, ABEF-in dhe TIK-un.

Krahas zhvillimit të aktiviteteve të planifikuara, gjithashtu janë vazhduar aktivitetet në fusha të reja hulumtuese, si plani mbi implementimin e Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (SILC), anketë rekomanduar nga Eurostati, e që do të zhvillohet për herë të parë në Kosovë, gjatë vitit 2018, me fondet e Bankës Botërore.

Megjithatë, dy raporte (publikime) të planifikuara nuk janë publikuar “Statistikat e Sportit 2016” dhe “Statistikat mbi Shkaqet e Vdekjeve 2014-2015”, si rezultat i neglizhencës të institucionet përkatëse Federatat Sportive dhe IKSHPK, të cilat nuk i kanë raportuar të dhënat tek ASK-ja, edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të ASK-së për grumbullimin e këtyre të dhënave.

## 1.6. Statistikat e Bujqësisë dhe të Mjedisit

Në fushën e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitin 2017, në përputhje me planin dhe dinamiken së paraparë. Gjatë vitit 2017 është evidentuar progres në shkurtimin e afateve kohore të publikimeve, në përmirësimin e cilësisë dhe në harmonizimin me metodologjitë e Eurostatit (BE), në veçanti është bërë ndërrimi i vitit bazik, të Indeksit të Çmimeve të

Prodhimeve dhe Inputeve në Bujqësi nga 2010=100 në 2015=100.

Nga statistikat e bujqësisë janë publikuar rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB) 2016. Nga të dhënat e Regjistrimit të bujqësisë 2014, është realizuar publikimi tematik-special "Kulturat e Arave në Republikën e Kosovës 2014" si dhe është përgatitur në formë drafti publikimi "Vreshtaria në Republikën e Kosovës 2014".

Gjatë kësaj periudhe janë kryer parapërgatitjet për realizimin në terren të Anketës së Ekonomive Bujqësore 2017, grumbullimi i të dhënave në terren dhe monitorimi i zhvillimit të AEB 2017, në terren si dhe është bërë kontrollimi i cilësisë së plotësimit të pyetësorëve të kësaj ankete

Tek Statistikat Agromonetare, në baza tremujore janë publikuar, "Indeksi i Çmimeve të Prodhimit dhe Çmimet në Bujqësi" (TM4 2016 dhe TM1-TM3 2017) si dhe "Indeksi i Çmimeve të Inputeve në Bujqësi" (TM4 2016 dhe TM1 - TM3 2017) me vitin bazë 2010 = 100.

Në baza vjetore janë publikuar "Indeksi i Çmimeve të Prodhimit dhe Çmimet në Bujqësi 2010–2017", "Indeksi i Çmimeve të Inputeve në Bujqësi 2010–2016" dhe Llogaritjet Ekonomike në bujqësi 2016.

Është bërë ndërrimi i vitit bazë, Indeksit të Çmimeve të Prodhimeve dhe Inputeve në Bujqësi nga 2010=100 në 2015=100, dhe është bërë monitorimi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore dhe përpunimi i tyre.

Në Statistikat e Mjedisit- janë publikuar, "Anketa e Mbeturinave Komunale 2016", "Anketa e Mbeturinave Industriale 2016", "Fakte mbi mjedisin 2016" dhe "Anketa e Mbeturinave të Trajtuara 2016".

Janë grumbulluar të dhëna nga burimet administrative për statistikat e ujërave, statistikat e ajrit, fakte mbi mjedisin dhe për statistikat tjera të bujqësisë dhe mjedisit.

Në prodhimin e Statistikave të bujqësisë, agromonetare dhe të mjedisit, janë zbatuar rregulloret, metodat dhe udhëzimet sipas standardeve të organizatave ndërkombëtare, në veçanti ato të Eurostatit.

Në fushën e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, gjatë vitit 2017, janë publikuar gjithsej, 17 publikime (raporte statistikore) kuartale dhe vjetore.

## *1.7. Përpunimet e Veçanta të Statistikave Zyrtare*

Sipas Nenin 33 të Ligjit për Statistika Zyrtare, Udhëzimit Administrativ për përpunimin e veçantë të statistikave zyrtare, Nr.08/12, si dhe Udhëzimit Administrativ, numër 2004/07-MSHP, gjatë vitit 2017, ka vazhduar realizimi i projekteve, sipas marrëveshjeve për përpunim të veçantë të statistikave zyrtare.

Duke zbatuar procedurat e mësipërme ligjore, ASK-ja ka realizuar aktivitete për pilot-projektet nga fondi i IPA-së 2014 , në statistikat ekonomike, sociale, statistikat e bujqësisë dhe në fushën e metodologjisë dhe teknologjisë informative. Gjithashtu, është realizuar hulumtimi për matjen e kapaciteteve të turizimit në Kosovë i mbështetur nga "Swise Agency for Development and Cooperation in Kosovo" (SADC).

Këto aktivitete të zhvilluara kanë ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale, duke rritur sasinë dhe cilësinë e prodhimeve statistikore, gjë që kanë mundësuar motivim të stafit që kanë marr pjesë në realizimin e këtyre pilot-projekteve.

Siq është cekur më lartë, qëllimi i këtyre pilot projekteve është ngritja e kapaciteve të stafit, me qëllim të rritjes së numrit të indikatorëve ( të dhënave të reja) dhe përmirësimi i cilësisë së atyre ekzistuese. Prandaj, edhe pilot projektet kanë qene të shpërndara sipas fushave të identifikuara për përmirësimet përkatëse.

Në vijim janë paraqitur më dëtajisht pilot projetet e realizuara gjatë vitit 2017, të mbështetura nga Komisioni Evropian, në kuadër te programit IPA MB 2014.

Titujt e Pilot projekteve në kuadër të IPA MB 2014:

1. PP1 Metodologjia e Llogarive Kombëtare
2. PP2 Programi i transmisionit të ESA 2010
3. PP3 Statistikat e Financave të Qeverisë
4. PP4. Statistikat e Çmimeve - Pariteti i Fuqisë Blerëse
5. PP6. Përmirësimi i Regjistrit Statistikor të Bizneseve
6. PP10. Statistikat e Tregtisë se jashtëm të mallrave
7. PP13. Statistikat e Transportit
8. PP14. Statistikat Afatshkurtra të Bizneseve
9. PP15. Statistikat e Turizmit
10. PP17. Statistikat e Çmimeve - Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)
11. PP20 Identifikimi i burimeve për kalkulimin e indikatorëve makroekonomik për procedura balancuese.
12. PP21 Statistikat Vjetore të Kulturave Bujqësore Bimore
13. PP 22 Statistikat e Prodhimtarisë Blegtorale
14. PP 16 Anketa e Fuqisë Punëtore
15. PP09. Për statististikat e anketës EU-SILC
16. PP12. Për statistikat e informacionit dhe komunikimit
17. PP07. Zhvillimi i Statististikave zyrtare mbi krimet
18. PP18. Për zhvillimin e sistemit të metadatave
19. PP05. Për menaxhimin e kualitetit
20. PP19. Strategjia e Evropës juglindore 2020
21. PP23 Raporti mbi aktivitetet horizontale

Gjithashtu gjatë vitit 2017, kanë filluar aktivitetet për realizimin e pilot projekteve në kuadër të programit IPA MB 2015.

## *1.8. Metodologjia, Shpërndarja dhe Teknologjia Informative*

Sipas kërkesave në aspektin e metodologjisë, gjatë vitit 2017, është bërë nxjerrja e mostrave për të gjitha anketat e parashtruara nga statistikat prodhuese, si dhe të hulumtimeve të tjera statistikore.

Është bërë përshkrimi i metadatave për 38 produkte statistikore, sipas formatit ESMS dhe 5 produkteve tjera ne formatin ESQRS. Metadatat e përshkruara janë të publikuara në ueb faqen e ASK-së, në tri gjuhë. Është bërë llogaritja e indikatorëve të cilësisë dhe gabimeve në mostër për 5 produktet e përshkruara në ESQRS (PP18).

Përpilimi i programit në aplikacionin “R” per nxjerrjen e mostrës, llogaritjen e gabimeve në mostër dhe llogaritjen e indikatorëve për raportin e cilësisë.

Në kuadër të shpërndarjes-diseminimit, në vitin 2017 është realizuar dhe publikuar në baza tremujore, Buletini Tremujor (TM4 2016, TM1, TM2 dhe TM3 2017)

Në baza vjetore janë publikuar, Vjetarit Statistikor 2018, Kosova në shifra 2017, Katalogu i publikimeve 2017, Fletëpalosja e ASK-së, Kalendari i publikimeve për vitin 2018.

Është bërë standardizimi i të gjitha publikimeve, paisja me ISBN numër, dhe katalogimi i publikimeve Vjetore për të gjitha publikimet e ASK-së.

Janë realizuar dy anketa të rendësishme, anketa e Kënaqshmërisë së Përdoruesve, ku rezultatet e kësaj ankete janë të publikuara në Ueb faqen e ASK-ës, si dhe për herë të parë është bërë edhe Anketa e kënaqshmësisë së stafit të ASK-ës.

Përmes TI-së, është bërë një menaxhim më efektiv i proceseve prodhuese statistikore dhe është siguruar

një infrastrukturë teknologjike e sigurt dhe shumë e besueshme për të gjitha departamentet e ASK-së.

Është vazhduar me integrimin e bazës së të dhënave dhe sistemet e përpunimit, si dhe harmonizimi i mjeteve të përdorura, me qëllim që të ketë efikasitet, transparencë dhe lehtësi si për për prodhime statistikore e po ashtu edhe për përdorimin e tyre nga shfryetëzuesit e ndryshëm.

Është zhvilluar dhe integruar sistemi i metadatave në ueb faqen e ASK-ës sipas standartit të Eurostatit, ESMS.

Është krijuar një “file share” mes ASK-së dhe Doganave të Kosovës, në Serverët e ASHI-së, për shkëmbimin e të dhënave për tregtinë e jashtme.

Është punuar me të dhënat e regjistrimeve të popullsisë dhe ekonomive familjare nëpër vite 1948-2011, dhe verifikimi i diferencave, në mes ekonomive familjare të publikuara dhe ekonomive familjare në kornizën e qarqeve regjistruese.

Është bërë zhvillimi dhe përditësimi i mëtejmë i platformës online ASKDATA, duke i integruar të gjitha të dhënat statistikore, sipas serive kohore në baza mujore dhe vjetore, për tema të ndryshme statistikore.

Qasja në të dhënat e integruara në platformën ASKDATA, ka një rëndësi të veçantë për shfrytëzuesit e të dhënave, pasi kjo platformë është sipas rekomandimeve të Eurostat, UNECE dhe OECD.

Dërgimi i të dhënave në Eurostat është bërë sipas standardeve të përcaktuara në platformën e tyre eDAMIS (platformë e dërgimit të të dhënave statistikore në Eurostat) proces ky i cili vazhdon edhe në të ardhmen.

Në vitin 2017 janë dërguar 271 dataseta (bashkësi e të dhënave).

**Figura: 1.3: Numri i të dhënave të dërguara në Eurostat përmes eDAMIS**




Në bashkëpunim me MF dhe Bankën Qendrore, është implementuar Sistemi i Avancuar i Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme i FMN-së.

Në vazhdimësi, në baza mujore dhe tremujore KAS dërgon të dhënat në FMN, në formatin SDMX, për disa tema statistikore.

## 1.9. Racionalizimi dhe Ngritja e Kapaciteteve në ASK

Në aspektin e racionalizimit të vendeve të punës dhe bazuar në rregulloret në fuqi, është bërë racionalizimi i disa pozitave në ASK. Këto veprim janë në kuadër të rekomandimeve që kanë dalë nga vlerësimi ndërkombëtarë “Peer Review”.

Me aprovimin e 10 pozitave të reja të vendeve të punës, ndryshohet organogrami i ASK-së, sipas dispozitave ligjore, nga neni 14, pika 3 dhe 4 të Rregullores Nr. 01/2013 per riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të Punës së Agjencisë së Statistikave të Kosovës, si dhe ne bazë te Ligjit nr.06/L-020 për Buxhetin e vitit 2018. Në këtë mënyrë është krijuar Departamentit i statistikave të llogarive kombëtare, si njësi e re në ASK.

Gjithashtu 10 pozitat e reja janë shperndarë edhe tek statistikat sociale, ekonomike dhe në TI.

Pozitat e lira, që janë krijuar me rastin e daljes në pension, ASKja i ka proceduar për rekrutim sipas procedurave në fuqi.

Gjatë vitit 2017, stafi i ASK-së ka pasur trajnime në fusha të caktuara statistikore. Në termat afatgjatë të trajnimit kanë përfituar tre zyrtarë të ASK-së, një në fushën e komunikimit, një në fushën e statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, dhe një në fushën e statistikave të mjedisit, që janë financuar nga programi shumë përfitues IPA-2014. Në trajnimet afatshkurtra, stafi i ASK-së dhe institucionet e tjera kanë marrë pjesë në aktivitete të shumta statistikore si, seminare, konferenca, vizita studimore dhe të tjera.

Numri i aktiviteteve (numri i trajnimeve, seminareve, grupeve punuese, vizitave studimore, konferencave, etj.) me qëllim të ngritjes së kapaciteteve ishte rreth 150 sosh, ndërsa, numri i zyrtarëve pjesëmarrës në këto aktivitete, ishte, gjithsej 189, përfshirë zyrtarët e BQK-së, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Numri i aktiviteteve si trajnimet, seminaret, grupet punuese, vizitat studimore, konferencat, etj. me qëllim të ngritjes së kapaciteteve ishte rreth 162, ndërsa, numri i zyrtarëve pjesëmarrës në këto aktivitete ishte gjithsej 211, përfshirë zyrtarët e BQK-së, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Nga SIDA janë zhvilluar, gjithsej, 20 aktivitete, (vizita studimore, kurse verore regjionale, trajnime, takime përfaqësuese, punëtori, etj) në të cilat janë përfshirë rreth 70 zyrtarë të ASK-së, si dhe janë zhvilluar misione në ASK, me qëllim të ngritjes së kapaciteve të ASK-së.

E gjithë kjo mbështetje është financuar kryesisht nga organizatat ndërkombëtare si, Eurostati, SIDA (SCB), Banka Botërore, FMN, etj.

Sipas planeve strategjike të ASK-së, konkretisht PSZ-së 2013-2017 dhe planit vjetor për vitin 2018, ASK-ja, ka dërguar kërkesat të institucionet vendimmarrëse për më shumë pozita të reja.

Numri i pamjaftueshëm i stafit ka ndikuar dhe do të ndikojë në prodhimin e statistikave, sipas standardeve dhe metodologjisë ndërkombëtare.

## 1.10. Pasqyrat e Performancës së ASK-së

Monitorimi, konsiderohet si njëra ndër proceset e rëndësishme në kuadër sistemit menaxhues lidhur me proceset statistikore në ASK. Përmes sistemit të SIPK-ut, gjatë vitit 2017, është bërë matja e përformancës, krahasuar me vitin paraprak, për numrin e produkteve dhe publikimeve statistikore, kohës prodhuese, numrin e ditëve për produkt, normën e publikimeve në kohë, etj. Rezulltatet e prezentuara menaxhohen përmes KVP, në kuadër të secilës ekzistojnë indikatorët, sistematizimi i të cilëve bëhet përmes sistemit të SIPKut.

Produktet/Publikimet statistikore - Gjatë vitit 2017, numri i produkteve, respektivisht publikimeve statistikore, ka shënuar rritje të konsiderueshme, krahasuar me një vit më parë. Objektivi i caktuar në Programin e Statistikave Zyrtare 2013-2017, lidhur me numrin e produkteve statistikore, është arritur që në fund të vitit 2014. Derisa në fund të vitit 2017, ASK-ja ka arritur t'i prodhoj 60 produkte statistikore dhe 121 publikime (raporte statistikore), krahasuar me vitin 2016, ku numri i produkteve statistikore të publikuara ishte 54, respektivisht 115 publikime statistikore. Shprehur në tregues strukturorë, përformanca nga pikëpamja e prodhimit statistikor, gjatë vitit 2017, në raport me vitin 2016, ka shënuar rritje në shkallën prej 11.1% në produkte statistikore, ndërsa numri i publikimeve statistikore në vitin 2017, në raport me vitin 2016 ka shënuar rritje në shakllen prej 5.2 %.

Numri i publikimeve statistikore zakonisht është i barabartë ose më i madh se numri i produkteve statistikore, por ekzistojnë edhe raste kur një aktivitet figuron si produkt statistikor, por nga i cili mund edhe të mos rezultoj publikim statistikor, ngase frekuenca e publikimit mund të mos korospondon me vitin referues si psh. Raporti "Burrat dhe Gratë", publikohet në çdo dy, vite dhe si rrjedhoj nuk është i publikuar.

Numri i ditëve për produkt - gjatë vitit 2017, për prodhimin e një produkti statistikor janë harxhuar mesatarisht 123 ditë pune për produkt. Krahasuar me vitin 2016, për prodhimin e një produkti statistikor janë harxhuar mesatarisht 133 dite pune për produkt ( krahasimi për të njëtat produkte statistikore, viti 2016 = 54 produkte statistikore). Nga kjo mund të konkludojme se efikasiteti organizativ si njëri ndër shtyllat kryesore te programit stretegjik, ka qenë i zbatueshëm edhe gjatë vitit 2017. Në strukturë efikasiteti organizativ dhe prodhues ka shënuar rritje në shkallën prej 10% apo nga 133 në 123 ditë pune, për produkt. Shprehur në vlera absolute nga 7172 ditë në 6621 ditë për 54 produktet , ndërsa numri i ditëve për publikim (raport) statistikor mesatarisht ishte 55.7 dite pune për publikim statistikor. (6621/115).

Koha Prodhuese – si edhe në vitet paraprake edhe gjatë vitit 2017, njëri ndër qëllimet e ASK-së, ishte dhe mbetet shkurtimi i kohës prodhuese në publikimin e raporteve statistikore me qëllim të vënies në dispozicion sa më shpejtë që është e mundur për shfytëzuesit. Të dhënat nga SIPK-u, shfaqin përformancë variuese (sipas departamenteve) në vitin 2017, në krahasim me vitin 2016. Në nivel të ASK-së, të dhënat nga SIPK-u, tregojnë se koha prodhuese e prodhimeve statistikore për vitin 2017 ka regjistruar rënie të konsiderueshme, në raport me vitin 2016, për (-1289) ditë apo shprehur në strukturë rreth -10.9%. Kjo si rezultat i shkurtimit të kohës prodhuese, gjegjësisht, afateve kohore në ofrimin e publikimeve statistikore për shfrytëzuesit e statistikave zyrtare. Njëra ndër kërkesat kryesore të shfrytëzuesve për të dhëna staistikore ishte dhe mbetet shkurtimi i afateve kohore, gjegjësisht, ofrimi më i shpejte i të dhënave zyrtare në raport me periudhën të cilës i referohet hulumtimi. Në këtë rrafsh top menaxhmenti dhe i tërë stafi i ASK-së, kanë qenë të angazhuar në realizimin e këtij objektivi. Prandaj mund të konkludohet se është arritur përformance më e mirë gjatë vitit 2017, duke ofruar të dhënat zyrtare tek përdoruesi, me një efikasitet prej reth 11% më të lartë (kohë më e shkurtër: studimi-produkti të shfrytëzuesi) krahasur me te njëjtat periudhë të një viti më pare 2016, për të njëtëta publikime statistikore. Ky progres ndihmon prioritetet në përgjithësi që ka ASK-ja, sidomos në të dhënat me prioritet të lartë për përdoruesit vendor dhe ndërkombëar (të dhënat socio-ekonomike) dhe në zhvillimin e kapaciteteve menaxheriale dhe organizative të ASK-së.

Norma e publikimeve në kohë - njëri ndër Parimet e Kodit të praktikave të statistikave evropiane i cili ndikon në rritjen e kualitetit të statistikave zyrtare është edhe publikimi i raporteve statistikore në kohë të saktë sipas kalendarit të publikuar më parë. Në këtë drejtim të dhënat nga SIPK-u, shfaqin një normë të lartë të publikimeve në kohë. Nga, gjithsej, 121 publikimet/raportet statistikore, 120, gjegjësisht, 99% janë publikuar në kohën e paraparë, krahasur me vitin 2016, ku norma e publikimeve në kohë ishte 96%, publikime të publikuara në kohë, sipas kalendarit të publikimeve.

Korniza e Vlerësimit të Përformancës (KVP) është duke u plotësuar dhe fuqizuar nga viti në vit, për të dhënë raporte sistematike për zhvillimin e kualitetit të statistikave. Pasqyrë më të qartë, lidhur me zhvillimin e kualitetit, pritet të ketë në periudhën e ardhshme, sidomos për indikatorët 7 dhe 8.

Në tabelat e mëposhtme janë dhënë pasqyrat e përformancës, në nivel të ASK-së dhe në nivel të departamenteve, sipas treguesve të nxjerrë nga Sistemi i Përdorimit të Kohës (SIPK).

**Tabela: 1. Pasqyra e Performancës në nivel të ASK-së (SIPK)**

Treguesi 1. Numri i produkteve dhe raporteve Statistikore 2016/2017

| Fushat Statistikore | Produktet 2016 | Produktet 2017 | Publikime statistikore 2016 | Publikime statistikore 2017 |
|---|---|---|---|---|
| **Ekonomike** | 23 | 25 | 74 | 76 |
| **Bujqësisë** | 11 | 12 | 17 | 17 |
| **Sociale** | 15 | 16 | 16 | 19 |
| **Të përgjitshme** | 05 | 07 | 08 | 09 |
| **Gjithsej** | 54 | 60 | 115 | 121 |

Treguesi 4. Ditë pune – planifikuar dhe realizuar benda proceseve prodhuese fazat 1-7

| Fushat Statistikore | Ditë pune të planifikuara 2017 | Ditë pune të realizuara 2017 | Ndryshimi (%) |
|---|---|---|---|
| **Ekonomike** | 4186 | 2561 | -39 |
| **Bujqësisë** | 1918 | 1523 | -21 |
| **Sociale** | 2743 | 2626 | -04 |
| **Të përgjitshme** | 212 | 241 | +14 |
| **Gjithsej** | 9059 | 6951 | -23 |

Treguesi 4. Ditë pune - për të gjitha produktet brenda dhe jashtë procesit prodhues fazat 1-7 dhe 8-11

| Fushat Statistikore | Total dite pune | Në procesin prodhues | Jashtë procesit prodhues | proporcioni i jashtëm (%) |
|---|---|---|---|---|
| **Ekonomike** | 3094 | 2561 | 533 | 17.2 |
| **Bujqësisë** | 1691 | 1523 | 168 | 9.9 |
| **Sociale** | 3168 | 2626 | 542 | 17.1 |
| **Të përgjitshme** | 575 | 241 | 334 | 41.9 |
| **Gjithsej** | 8528 | 6951 | 1577 | 18.5 |

Treguesi 5. Koha prodhuese për produktet e krahsueshme 2017/2016 / viti 2016=54 produkte

| Fushat Statistikore | Koha prodhuese 2016 | Koha prodhuese 2017 | Ndryshimi | Ndryshimi % |
|---|---|---|---|---|
| **Ekonomike** | 5868 | 4961 | -907 | -15.4 |
| **Bujqësisë** | 1907 | 1871 | -36 | -1.88 |
| **Sociale** | 3353 | 2991 | -362 | -10.7 |
| **Të përgjitshme** | 637 | 653 | +16 | +2.5 |
| **Gjithsej** | 11765 | 10476 | -1289 | -10.9 |

